

20160270704

**L I G J**  
**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR SIGURIM PENSIONAL DHE**  
**INVALIDOR**

Neni 1

Në Ligjin për sigurim pensional dhe invalidor (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 98/12, 166/12, 15/13, 170/13, 43/14, 44/14, 97/14, 113/14, 160/14, 188/14, 20/15, 61/15, 97/15, 129/15, 147/15, 154/15, 173/15 dhe 217/15) në nenin 11 në paragrafin (2) pas fjalës “ i siguruar” vendoset presje dhe shtohen fjalët: “formular me të cilin paraqitet kërkesa dhe dokumentacioni i nevojshëm.”

Neni 2

Në nenin 12 pas paragrafit (3) shtohet paragraf i ri (4), si vijon:

“(4) Formularin e kërkesës nga paragrafi (2) të këtij neni dhe dokumentacionin e nevojshëm për sigurimin e vazhduar i përcakton ministri i Punës dhe Politikës Sociale në pajtim me ministrin e Shoqërisë Informatike dhe Administratës”.

Neni 3

Neni 17 ndryshon si vijon:

“Formularin e kërkesës dhe dokumentacionin e nevojshëm për sigurim të detyrueshëm pensional dhe invalidor në bazë të invaliditetit dhe dëmtimit trupor i përcakton ministri i Punës dhe Politikës Sociale në pajtim me ministrin e Shoqërisë Informatike dhe Administratës.”

Neni 4

Në nenin 112 pas paragrafit (2) shtohen dy paragrafë të rinj (3) dhe (4) si vijojnë:

“(3) Përcaktimi i stazhit të sigurimit me kohëzgjatje të zmadhuar nga paragrafi (1) të këtij neni kryhet pas kërkesës së paraqitur nga i siguruari te filiali i Fondit në bazë të vendit të sigurimit.

(4) Formularin e kërkesës nga paragrafi (3) të këtij neni dhe dokumentacionin e nevojshëm për përcaktimin e stazhit të personit të siguruar me kohëzgjatje të zmadhuar i përcakton ministri i Punës dhe Politikës Sociale në pajtim me ministrin e Shoqërisë Informatike dhe Administratës.”

Neni 5

Në nenin 117 pas paragrafit (1) shtohen dy paragrafë të rinj (2) dhe (3) si vijon:

“(2) Pagesa e ndihmës pas vdekjes nga paragrafi (1) të këtij neni kryhet pas kërkesës së paraqitur në filialin e Fondit nga personi i cili ka kryer pagesën e shpenzimeve për varrim.

(3) Formularin e kërkesës nga paragrafi (2) të këtij neni dhe dokumentacionin e nevojshëm për pagesën e ndihmës pas vdekjes i përcakton ministri i Punës dhe Politikës Sociale në pajtim me ministrin e Shoqërisë Informatike dhe Administratës”.

Neni 6

Në nenin 124 në paragrafin (1) pika shlyhet dhe shtohen fjalët: “në formë elektronike”.

Pas paragrafit (1) shtohet paragraf i ri (2), si vijon:

“(2) Evidenca e të dhënave nga paragrafi (1) të këtij neni përmban: kontribute për anëtarët e fondit të detyrueshëm pensional nga obligimet për pagesën e kontributeve për sigurim pensional dhe invalidor, transferime të kontributeve të anëtarëve të fondeve të detyrueshme pensionale në llogaritë e fondeve të detyrueshme pensionale, transferime të kryera të kontributeve, llogari

individuale të anëtarëve nga i cili shihet gjendja e kontributeve të paguara për anëtarët në secilin fond të detyrueshëm pensional dhe raporte të rregullta përmbledhëse me kërkesë të Agjencisë për Supervizion të Sigurimit Pensional me Financim Kapital për shkak të realizimit të funksioneve të saj.”

#### Neni 7

Në nenin 125 pas paragrafit (4) shtohen dy paragraf të rinj (5) dhe (6) si vijon:

"(5) Përcaktimi i cilësisë së personit të siguruar për personat nga paragrafi (4) pikat 2), 3) dhe 5) të këtij neni, kryhet pas parashtrimit të kërkesës.

(6) Formularin e kërkesës nga paragrafi (5) të këtij neni dhe dokumentacionin e nevojshëm për përcaktimin e cilësisë së personit të siguruar nga paragrafi (4) pikat 2), 3) dhe 5) të këtij neni i përcakton ministri i Punës dhe Politikës Sociale në pajtim me ministrin e Shoqërisë Informatike dhe Administratës.“

Paragrafi (5) bëhet paragraf (7).

Paragrafi (6) i cili bëhet paragraf (8) ndryshon si vijon:

“(8) Nëse personat nga paragrafi (4) pikat 2), 3) dhe 5) të këtij neni nuk paraqesin fletëparaqitje, cilësinë e personit të siguruar e konstaton Fondi me detyrë zyrtare në bazë të të dhënave nga institucione kompetente se personat i plotësojnë kushtet për përcaktimin e cilësisë së personit të siguruar, në afat prej 15 ditë nga dita e marrjes së të dhënave.”

#### Neni 8

Në nenin 126 pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3), si vijon:

“(3) Formularin e kërkesës nga paragrafi (1) të këtij neni dhe dokumentacionin e nevojshëm për realizimin e të drejtës për pensionin e moshës, pensionin familjar, pensionin invalidor, kompensim me para për dëmtim trupor, kërkesën dhe dokumentacionin e nevojshëm për përcaktimin e invaliditetit dhe formularin e propozimit nga paragrafi (2) të këtij neni i përcakton ministri i Punës dhe Politikës Sociale në pajtim me ministrin e Shoqërisë Informatike dhe Administratës.”

Paragrafët (3), (4), (5) dhe (6) bëhen paragrafë (4), (5), (6) dhe (7).

#### Neni 9

Në nenin 128 pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3), si vijon:

“(3) Formularin e kërkesës nga paragrafi (1) të këtij neni dhe dokumentacionin e nevojshëm për ndryshimin e gjendjes së invaliditetit dhe dëmtimit trupor të personit të siguruar i përcakton ministri i Punës dhe Politikës Sociale në pajtim me ministrin e Shoqërisë Informatike dhe Administratës. “

#### Neni 10

Pas nenit 131 shtohet nen i ri 131-a, si vijon:

##### “Neni 131-a

“(1) Komisioni për vlerësimin e aftësisë për punë mban evidencë mbi konstatimin e miratuar, vlerësimin dhe mendimin nga neni 130 paragrafi (1) të këtij ligji, në pajtim me Ligjin për procedurë të përgjithshme administrative, i cili përmban: të dhëna personale për të siguruarin, përgatitja profesionale e të siguruarit, vendi i punës ose profesioni, dega e veprimtarisë në të cilën punon, emri i punëdhënësit, anamneza, dokumentacioni mjekësor i shfrytëzuar gjatë miratimit të konstatimit, vlerësimit dhe mendimit, gjendja objektive e të siguruarit gjatë kontrollit, diagnoza e sëmundjes me shifër të sëmundjes, sipas MKB- 10, vlerësim dhe mendim për aftësinë për punë, shkaku i invaliditetit, përqindja e invaliditetit, data e shkaktimit të invaliditetit ose dëmtimi trupor dhe nevoja për kontroll me datën e ekzaminimit kontrollues.

(2) Komisioni për revizionin e konstatimit, vlerësimit dhe mendimit për përcaktimin e invaliditetit, respektivisht për punë mban evidencë mbi revizionin e kryer të nenit 131 të këtij ligji, në pajtim me Ligjin për procedurë të përgjithshme administrative, e cila përmban: numrin rendor dhe numrin e lëndës, datën e parashtrimit të lëndës, emri dhe mbiemri i të siguruarit, numri amë i personit të siguar, mendimi i dhënë në procedurën e revizionit, data e zgjidhjes së lëndës në procedurën për revizion, respektivisht konstatim, vlerësim dhe mendim të Komisionit për vlerësimin e aftësisë për punë ose Komisionit për kontroll ekzaminues të detyrueshëm.“

#### Neni 11

Në nenin 132 në paragrafin (1) numri “60” zëvendësohet me numrin “30”.

Pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3), si vijon:

“(3) Aktvendim për të drejtat e sigurimit pensional dhe invalidor me zbatimin e dispozitave të marrëveshjeve për sigurim social miraton Fondi, më së voni në afat prej 90 ditë nga dita e parashtrimit të kërkesës.”

Paragrafi (3) bëhet paragraf (4).

#### Neni 12

Në nenin 132-a pas paragrafit (5) shtohet paragraf i ri (6), si vijon:

“(6) Seksioni për revizion nga paragrafi (2) të këtij neni, mban evidencë në pajtim me Ligjin për procedurë të përgjithshme kontestimore për lëndët për të cilat është kryer revizionin i cili përmban: emërtimin e filialit i cili ka miratuar aktvendimin, llojin e të drejtës, lëndët për të cilat është kryer revizioni, lëndët për të cilat është konfirmuar aktvendimi, lëndët për të cilat nuk është konfirmuar aktvendimi për shkak të zbatimit të gabuar të akteve ligjore dhe nënligjore dhe aktvendime për të cilat lëndët janë kthyer, respektivisht nuk janë konfirmuar për shkak të dorëzimit të provave të nevojshme.”

#### Neni 13

Neni 133 shlyhet.

#### Neni 14

Në nenin 160 paragrafi (1) pika 6) në alinenë 4 fjala “ose” shlyhet.

Alineja 5 shlyhet.

#### Neni 15

Në nenin 185 pas paragrafit (1) shtohet paragraf i ri (2), si vijon:

“(2) Për vendosje në shtëpitë dhe banesat për jetesë nga paragrafi (1) të këtij neni shfrytëzuesi i pensionit paraqet kërkesë te filiali ose dega e Fondit sipas vendit të jetesës.“

Në paragrafin (2) i cili bëhet paragraf (3) pika në fund të fjalisë zëvendësohet me presje dhe shtohen fjalët: “formularin e kërkesës nga paragrafi (2) të këtij neni dhe dokumentacionin e nevojshëm.”

Paragrafët (3) dhe (4) bëhen paragrafë (4) dhe (5).

Pas paragrafit (5) shtohet paragraf i ri (6), si vijon:

“(6) Fondi mban evidencë për shpërndarjen e shtëpive dhe banesave për jetesë në pajtim me Ligjin për procedurë të përgjithshme administrative, e cila përmban: kërkesat e paraqitura për vendosje në shtëpitë dhe banesat për jetesë, vendime të marra dhe rezultate nga secila shpërndarje elektronike e shtëpive dhe banesave për jetesë të shfrytëzuesve të pensionit.”

#### Neni 16

Pas nenit 185 shtohet nen i ri 185-a, si vijon:

“Neni 185-a

(1) Komisioni nga neni 185 paragrafi (4) nga ky ligj në afat prej 30 ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës për vendosje në shtëpitë dhe banesat për jetesë e shqyrton kërkesën dhe miraton njoftim për plotësimin e kushteve për vendosje në shtëpitë dhe banesat për jetesë.

(2) Kundër njoftimit nga paragrafi (1) i këtij neni parashtruesi i kërkesës ka të drejtë për kundërshtim te Fondi në afat prej tetë ditë nga dita e pranimit të njoftimit.”

Neni 17

Në nenin 207 paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

“Dëshmia nga paragrafi (1) i këtij neni lëshohet në afat prej 15 ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës.

Paragrafi (3) ndryshohet si vijon:

“Formularin e kërkesës për lëshimin e dëshmisë për të dhëna të futura në evidencën e amzës e përcakton ministri i Punës dhe Politikës Sociale në pajtim me ministrin e Shoqërisë Informatike dhe Administratës.“

Paragrafi (4) ndryshohet si vijon:

“Kundër dëshmisë nga paragrafi (2) i këtij neni, i siguruari ka të drejtë për kundërshtim te Fondi në afat prej tetë ditë nga dita e pranimit të dëshmisë.”

Paragrafët (5) dhe (6) shlyhen.

Neni 18

Aktet nënligjore të përcaktuara me këtë ligj do të miratohen në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 19

Procedurat e filluara deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji do të përfundojnë në pajtim me ligjin sipas të cilit kanë filluar.

Neni 20

Dispozitat nga nenet 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 15, 16 dhe 17 të këtij ligji, do të fillojnë të zbatohen me fillimin e zbatimit të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative në pajtim me nenin 141 të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 124/15).

Neni 21

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.